

VENDIM
Nr. 22, datë 21.1.2026

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË VLASHAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE
SHUPENZË, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR, NGA SHOQËRIA “GERTI”,
SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në Vlashaj, njësia administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria “GERTI” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “GERTI” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: J96829417K;
- c) Tipi i centralit: Fotovoltai;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltai do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e zonës së projektit dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e dokumentacionin e projektit;

g) Shoqëria “GERTI” sh.p.k., ka detyrimin që:
i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltai;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “GERTI” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin

e saj në vlerë monetare; në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "GERTI" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
KOORDINATAT E ZONËS SË PROJEKTIT

KOORDINATAT E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK
NË VLASHAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUPENZË, BASHKIA BULQIZË, QARKU
DIBËR, SHOQËRIA "GERTI" SHPK

KRGJSH	
X	Y
533785.46	4600073.72
533681.20	4600078.71
533586.63	4600092.52
533501.82	4600119.03
533450.17	4600114.44
533396.17	4600097.71
533342.70	4600112.09
533277.68	4600113.54
533253.22	4600101.36
533208.19	4600060.53
533207.29	4600017.02
533213.63	4599979.29
533305.98	4599932.36
533421.51	4599895.60
533541.78	4599872.29
533635.08	4599873.07
533700.77	4599873.83
533782.67	4599916.98

Planvendosja e zonës së projektit

